

Vendim nr. 81 datë 19.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 19.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ELMAZ AHMETAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i paragrafit “*Duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme*” në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si të papajtueshme me Kushtetutën.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f”, 134, shkronja “i” dhe 145, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të një grupi deputetësh, ka miratuar ligjin nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 96/2016), i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr.

208, datë 07.11.2016. Ligji ka në objektin e tij përcaktimin e rregullave lidhur me të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve, pranimin dhe emërimin e tyre, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, si dhe përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile.

2. Neni 3 i ligjit nr. 96/2016 përcakton vlerat themelore që përshkojnë të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve, midis të cilave përfshihet edhe pavarësia në ushtrimin e detyrës, e parashikuar në pikën 2 të këtij neni. Kjo dispozitë ligjore ka këtë përmbajtje “2. *Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*”.

3. Në datën 17.03.2023 kërkuesi Elmaz Ahmetaj i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e shprehjes “*duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme*” në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016, si e papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se përmbajtja e nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 lejon magjistratët gjyqtarë dhe prokurorë të abuzojnë, duke dhënë vendime të padrejta ndaj qytetarëve.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

5. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” e 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të

drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

6. Gjykata ka pohuar se bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuksi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në rastin në shqyrtim, kërkuksi ka parashtruar se shprehja “*duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme*” në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 duhet të shfuqizohet si antikushtetuese, pasi bazuar në këtë shprehje, magjistratët gjyqtarë dhe prokurorë japin vendime të padrejta ndaj qytetarëve. Ata nuk vlerësojnë faktet dhe provat e paraqitura nga palët, duke bërë të kundërtën. Neni 1, paragrafi i dytë, i KPC-së, përcakton se “*gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërrthënie ose është i paqartë*”. Pra, vetëm nëse ndodhet përpara këtyre fakteve, magjistrati mund të interpretojë ligjin sipas bindjes së tij të brendshme. Kur ligji, faktet dhe dokumentet janë të qarta, ato duhet të pranohen nga gjykatat siç janë realisht.

8. Nisur nga parashtrimet e kërkuksit, si dhe bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Kolegji vëren se ai ka paraqitur pretendime me natyrë përgjithësuese dhe nuk ka dhënë ndonjë argument për të provuar pasojat negative të ardhura ose të pritshme për të drejtat ose liritë kushtetuese të tij nga zbatimi i normës ligjore të kundërshtuar. Thënë ndryshe, Kolegji

konstaton se kërkuesi nuk ka justifikuar interesin e tij vetjak, real dhe të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk justifikon interesin e tij në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

10. Në përfundim, Kolegji çmon se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.